

BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE: TRAKTATET

Qerim Qerimi

I. HYRJE: *BURIMET*

Ndonëse nuk ka një kushtetutë që përcakton burimet ligjore dhe hierarkinë e tyre në të drejtën ndërkombëtare, ekziston megjithatë një përmbledhje ose deklaratë që tregon të paktën “burimet materiale” të së drejtës ndërkombëtare. Fjala është për nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, që është organi kryesor gjyqësor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lexon:

1. *Gjykata, funksioni i së cilës është të vendos në pajtim me të drejtën ndërkombëtare mosmarrëveshjet e paraqitura përpara saj, aplikon:*
 - (a) *konventat ndërkombëtare, qoftë të përgjithshme ose të veçanta, që krijojnë rregulla shprehimisht të pranuar nga shtetet kontestuese;*
 - (b) *zakonin ndërkombëtar, si dëshmi e një praktike të përgjithshme të pranuar si e drejtë;*
 - (c) *parimet e përgjithshme të së drejtës, të pranuar nga kombet e qytetëruara;*
 - (d) *subjekt i dispozitave të nenit 59,¹ vendimet gjyqësore dhe mësimet e publicistëve më të kualifikuar të kombeve të ndryshme, si mjete subsidiare për përcaktimin e rregullave të së drejtës.*
2. *Kjo dispozitë nuk e paragjykon pushtetin e Gjykatës për të vendosur një rast ex aequo et bono, në rast se palët pajtohen për këtë.*

Thënë teknikisht, neni 38 është menduar të aplikohet në rastin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, dhe mbi të gjitha, është një dispozitë që qeveris punën e Gjykatës Botërore. Por, në fakt, neni 38 ka pasur një jetë që shkon përtej përdorimit për nevoja të Gjykatës, duke ndihmuar që të përcaktojë autoritetin ligjor në bazë të të cilit vendimmarrësit dhe teoricienët e fushave të ndryshme, marrin vendime, ofrojnë rekomandime, zgjidhin probleme dhe krijojnë ose mbrojnë politika të ndryshme. Vlera e gjithmbarshme e kësaj dispozite, sidoqoftë, nuk është e pakufizuar. Kritika që i bëhet këtij neni ka të bëjë kryesisht me listën kufizuese dhe të pakompletuar të burimeve apo proceseve ligjberëse, në kuptimin që teksti i nenit 38 nuk lë shumë hapësirë për inovacione dhe flet pak për vendimet dhe rezolutat e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare ndërqeveritare.

Duhet thënë se, përkundër mungesave të mundshme dhe qartësisë së dëshirueshme që mbase kurrë nuk mund të jetë e plotë për një sistem që jeton dhe ndryshon, disa aspekte të burimeve janë trajtuar dhe qartësuar në proces përmes jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ndërsa të tjera aspekte, si rezultat i zhvillimit të përgjithshëm të fushës së të drejtës ndërkombëtare (shih veçanërisht diskutimin për aspektet që trajtohen në pjesët për “Burimet jo-

¹ Neni 59 parasheh: “Vendimet e Gjykatës nuk kanë forcë detyruese përveç në mes të palëve dhe në lidhje me atë rast të veçantë.”

tradicionale” dhe “Rregullat ‘tjera’ të së Drejtës Ndërkombëtare.”). Sido që të jetë, neni 38 përmban ato që tradicionalisht njihen si burimet “parësore” të autoritetit ligjor ndërkombëtar.

Në vijim paraqiten në mënyrë më të zgjeruar, përveç vetë burimeve, edhe elementet thelbësore të këtyre burimeve:

1. Marrëveshjet (traktatet) ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare paraqesin ligj për shtetet që janë palë të atyre marrëveshjeve dhe mund të çojnë në krijimin e të drejtës ndërkombëtare zakonore kur ato marrëveshje kanë për qëllim zbatimin nga shtetet në përgjithësi dhe në fakt janë të pranuar gjerësisht. Me fjalë të tjera, marrëveshjet ndërkombëtare krijojnë të drejta dhe detyrime (kryesisht të dyja) për shtetet palë.

Marrëveshjet, ose ndryshe konventat apo traktatet—variacione të tjera terminologjike, të parëndësishme për përmbajtjen apo substancën e një marrëveshjeje—janë mekanizmi parësor për zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare. Në renditjen e burimeve të përcaktuara në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, marrëveshjet ndërkombëtare janë të renditura të parat. Kjo nuk mund të merret doemos si paragjykim i rëndësisë së marrëveshjeve ndërkombëtare në raport me zakonet ndërkombëtare, ose përgjithësisht, si përcaktim i hierarkisë së burimeve të së drejtës ndërkombëtare, pasi në thelb kryejnë funksione plotësuese.

Vendosja e traktateve në fillim të listës së nenit 38 ka logjikë praktike dhe mund të shpjegohet me faktin se, një shtet duhet t’u përmbahet dhe njëkohësisht të mbahet përgjegjës për premtimet e tij formale, që në mënyrë tipike janë rezultat i negociatave dhe diskutimeve të shumta. Dhe, për shkak se një traktat—siç përkufizohet në nenin 2(1)(a) të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, nënkupton “një marrëveshje ndërkombëtare të lidhur në mes të shteteve [si dhe subjekteve të tjera] në formë të shkruar dhe që rregullohet nga e drejta ndërkombëtare”²—është një instrument që përmban premtimet e përbashkëta të shteteve palë ose subjekteve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, dhe duhet të jetë një burim veçanërisht i fuqishëm i të drejtës kundër një shteti ose subjekti të këtillë. Tomas Hobsi, në ndërtimin e Leviatanit—modelit të shtetit të tij—fillon me kontratën shoqërore, një pakt mitik në mes të themeluesve të shoqërisë mbështetur thjesht në pëlqimin e ndërsjellë. Pëlqimi i palëve është thelbi i një traktati; përbën kërkesën themelore dhe paraqet karakteristikën e veçantë të këtij burimi në krahasim me burimet e tjera.

Krijimi i traktateve është i mbështetur në shprehjen e lirë të vullnetit të palëve. Ky element i patjetërsueshëm i krijimit të traktateve paraqet karakteristikën kryesore dalluese në raport me procesin e formimit apo krijimit të zakonit ndërkombëtar. Për dallim nga traktatet, zakoni nuk është i krijuar nga pajtimi. Në thelb, zakoni krijohet me konsensus.

Një prezantim i aspekteve themelore mund të jetë i nevojshëm për të kuptuar tërësinë e mënyrës së veprimit të traktateve. Sikurse traktatet e tjera, edhe marrëveshjet për të drejtat e njeriut qeverisen nga e drejta ndërkombëtare e traktateve, e cila gjatë kohë ka qenë e drejtë zakonore

² Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969), *UN Treaty Series*, vol. 1155, fq. 331, neni 2(1)(a).

ndërkombëtare dhe në vitin 1969 është kodifikuar në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.³

a. Llojet e traktateve

Sipas numrit të palëve, traktatet mund të jenë dypalëshe (të lidhura ndërmjet dy palëve) dhe shumëpalëshe (të lidhura ndërmjet më shumë se dy palëve).⁴

Sa i përket përmbajtjes apo lëndës së tyre, ato mund të jenë politike, ekonomike apo financiare, juridike, për bashkëpunim në fushat kulturore, shëndetësore, zhvillimore, e kështu me radhë.

Kritere të tjera, të karakterit më tepër teknik sesa me ndonjë vlerë të posaçme juridike (për dallim prej atyre në nën-seksionin vijues “Natyra juridike e traktateve”), mund të përdoren për të klasifikuar traktatet, të tilla si shtrirja gjeografike, vlefshmëria kohore e traktatit, qëllimi, mundësia e aderimit, apo mënyra e lidhjes së tyre ose forma e tyre.

b. Natyra juridike e traktateve

Mbështetur në efektin juridik që prodhon, një traktat mund të shërbejë si një kontratë ndërkombëtare ndërmjet dy shteteve, ose mund të jetë çfarë nganjëherë quhet si traktat “ligjbërës”, dhe në raste më të rralla, mund të ketë efekte legjislative.

- i. Traktatet kontrata ose “kontraktuese”*: Disa autorë sugjerojnë se traktatet janë, thënë në mënyrë strikte, burime të obligimeve më tepër sesa burime të së drejtës. Kjo do të thotë se, traktatet nuk krijojnë regjime të parimeve ligjore dhe rregullave, por thjesht vënë në pah obligimet e ndërsjella, të cilat palët kanë ndërmarrë që t’i përmbushin. Traktatet e këtij lloji mund të quhen traktate “kontraktuese.”
- ii. Traktatet ligje ose “ligjbërëse”*: Këto lloj traktatesh kanë të bëjnë me krijimin e normave të përgjithshme ose regjimeve të përgjithshme ligjore në pajtim me të cilin palët në traktat pajtohen që të udhëheqin ose rregullojnë sjelljet e tyre dhe marrëdhëniet e tyre ndërmjet veti. Pra, një traktat ligjbërës mund të përfshijë një zotim të papërcaktuar kohor ndaj një regjimi të caktuar ligjor. Shembull tipik i një traktati të këtillë mund të jetë Traktati i Romës për themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane i vitit 1957, në kuptimin që operon si një lloj dokumenti kushtetues nga i cili buron ligji i cili i detyron shtetet palë të bashkësisë apo komunitetit *vis-a-vis* Komunitetit si të tërë në vend që thjesht të krijojnë obligime reciproke ndërmjet shteteve anëtare, sikur është rasti me traktatet kontrata. Karta e Kombeve të Bashkuara, për sa i përket anëtarëve të organizatës, po ashtu funksionon si një traktat kushtetues dhe ligjbërës, ku, për shembull, shtetet kanë obligime të përgjithshme ndaj bashkësisë ndërkombëtare për të mos prishur apo

³ *Shih id.*

⁴ *Shih*, për shembull, nenin 38(1)(a) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (“konventat ndërkombëtare, qoftë të përgjithshme ose të veçanta”).

cenuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, sikur që në këtë aspekt kanë dhe obligime dypalëshe ndaj njëri-tjetrit.

- iii. *Traktatet legislative:* Ndonëse nuk ka arsye që në parim të kundërshtohet praktika e shteteve për të krijuar traktatet ligjberëse, ka një kundërshtim në parim, sidoqoftë, ndaj atyre që quhen si traktate legislative, që do të thotë traktate, të cilat lidhen nga disa shtete të cilat synojnë të përcaktojnë ligjin dhe obligimet edhe ndaj atyre shteteve që nuk janë palë në traktat. E drejta zakonore ndërkombëtare dhe neni 34 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve e miratojnë qëndrimin se në përgjithësi një traktat nuk krijon të drejta dhe detyrime për një shtet të tretë pa pajtimin e tij. Në këtë kuptim, përgjigjja do të ishte se nuk ka traktate legislative, por në fakt ka disa traktate që, megjithatë, kanë karakter legjislativ. Për shembull, në rastin e *Reparacioneve për Dëmet e Shkaktuara në Shërbim të Kombeve të Bashkuara* (mendim këshillëdhënës i vitit 1949)⁵, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka mbajtur qëndrimin se, Karta e Kombeve të Bashkuara i ka krijuar Kombet e Bashkuara si një entitet që posedon “personalitet objektiv ndërkombëtar” dhe se Izraeli, ndonëse vend jo anëtar në kohën përkatëse, ka qenë i obliguar që ta njohë ekzistencën e Kombeve të Bashkuara dhe të paguajë dëmet për vrasjen e përfaqësuesit të Kombeve të Bashkuara në Jerusalem nga terroristët hebraikë. Profesori Hans Kelsen ka shkruar tutje, duke thënë se, Karta e Kombeve të Bashkuara vendos obligime të përgjithshme mbi shtetet jo-anëtare përmes nenit 2(6), që kërkon nga Kombet e Bashkuara “që të sigurojnë se shtetet që nuk janë anëtare të Kombeve të Bashkuara veprojnë në pajtim” me parimet e organizatës.⁶

c. Hyrja në fuqi dhe pranimi i traktateve

Negociatat lidhur me një traktat zhvillohen qoftë përmes diskutimeve në rastin e traktateve dypalëshe ose përmes një konference diplomatike, procedura më e zakonshme, për një traktat shumëpalësh. Në të dy rastet, delegatët mbeten në lidhje me qeveritë e tyre, ata i kanë me vete instruksionet paraprake, të cilat nuk u komunikohen palës tjetër, dhe në çdo fazë ata mund t'i konsultojnë qeveritë e tyre dhe të marrin udhëzime të reja, nëse kjo është e nevojshme.

Sa i përket traktateve shumëpalëshe, neni 9, paragrafi 2, i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve thekson se miratimi i një teksti në një konferencë ndërkombëtare duhet të bëhet me dy të tretën (2/3) e votave të shteteve të pranishme dhe që votojnë, përveç nëse me të njëjtën shumicë shtetet vendosin të aplikojnë një procedurë të ndryshme votimi.⁷

Kur të jetë arritur marrëveshja për draftin përfundimtar të traktatit, instrumenti është i gatshëm për nënshkrim.

⁵ *Reparation for Injuries Suffered in the Service of the United Nations (Advisory Opinion)* 1949 I.C.J. Reports 174.

⁶ HANS KELSEN, *PRINCIPLES OF INTERNATIONAL* (R. Tucker 2nd rev. ed. 1966).

⁷ Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, *supra* note 2, neni 9 (2).

- i. *Nënshkrimi* është zakonisht çështja më formale, madje edhe në rastin e traktateve dypalëshe. Në rastin e traktateve shumëpalëshe, nënshkrimi zakonisht bëhet me rastin e një sesioni formal përmbyllës (seance de cloture) me ç’rast secili delegat del përpara një tavoline dhe nënshkruan në emër të shefit të shtetit apo të qeverisë nga i cili është emëruar.
- ii. *Efektet e nënshkrimit*: Efekti i nënshkrimit të një traktati varet nëse traktati është subjekt për ratifikim, pranim, ose miratim. Nëse një traktat është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit, nënshkrimi nënkupton asgjë më tepër sesa atë që delegatët janë pajtuar lidhur me një tekst dhe janë të vullnetshëm që ta pranojnë atë dhe e referojnë te qeveritë e tyre për një veprim të tillë. Dhe, qeveritë mund të vendosin pastaj që të pranojnë ose refuzojnë traktatin.
- iii. *Ratifikimi*: Faza e pas nënshkrimit të një traktati ka të bëjë me miratimin nga qeveria, nëse një akt i tillë i konfirmimit është i nevojshëm. Praktika bashkëkohore sugjeron se, ratifikimi disponon me një vlerë më të madhe sesa thjesht si akt i konfirmimit, duke qenë se përfaqëson një deklaratë formale të një shteti për pajtimin e tij për të marrë detyrimet e një traktati. Neni 2 i Konventës së Vjenës, e përkufizon ratifikimin si “akt ndërkombëtar përmes së cilit një shtet vërteton vullnetin e tij në rrafshin ndërkombëtar për të qenë i detyruar nga një traktat.”⁸ Në pajtim me këtë, ratifikimi nuk del të ketë efekt retroaktiv, pra që të bëjë traktatin detyrues nga data e nënshkrimit. Procedura e ratifikimit, ndërkaq, mund të ndryshojë në varësi të sistemeve të ndryshme ligjore.

Në Republikën e Kosovës, procedura e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare është e përcaktuar në nenin 18 të Kushtetutës. Sipas dy paragrafëve përkatës të këtij neni:

“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.”⁹

Më tej, Kushtetuta përcakton se “[m]arrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen

⁸ *Id.* neni 2(1)(b).

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 18, para. 1 & 2.

në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.”¹⁰ Në këtë mënyrë, Kushtetuta kërkon që, proceduralisht, për t’i dhënë fuqinë zbatuese në planin e brendshëm, ajo duhet që, pas ratifikimit, të botohet në Gazetën Zyrtare. Pas këtij veprimi, marrëveshjet ndërkombëtare “zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.”¹¹ Pra, përveç rasteve kur një marrëveshje kërkon nxjerrjen e një akti ligjor për zbatim të saj, rregulli është që, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, pas publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare, bëhen pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës dhe ato mund të përdoren njësoj sikurse dispozitat e legjislacionit vendës. Në të vërtetë, sipas nenit 19(2) të Kushtetutës, “[m]arrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.”¹² Edhe pse nuk ka një referencë shprehimore, fjalëformimi “normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare,” si shtesë e marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk mund të kuptohet ndryshe përveçse si referencë të drejta ndërkombëtare zakonore.

d. Plotësimi dhe ndryshimi i traktateve

Shumë traktate, qoftë dy- apo shumëpalëshe përmbajnë dispozita që lejojnë mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të traktatit. Në rastin e traktateve dypalëshe, cilado prej palëve mund të propozojë një amendament, por pëlqimi i të dy palëve është i nevojshëm për miratimin e amendamenteve të propozuara.

Në rastin e traktateve shumëpalëshe, një ose më shumë palë mund të nisin procedurën për amendamentim dhe zakonisht vetëm miratimi i shumicës së amendamentit të propozuar është i nevojshëm për miratimin e amendamentit (shpesh dy të tretat ose tre të katërtat e votave). Çdo propozim për amendamentimin e një traktati shumëpalësh u duhet komunikuar të gjitha shteteve palë, dhe secili ka të drejtë të marrë pjesë (a) në vendimin lidhur me veprimin që duhet ndërmarrë për propozimin, dhe (b) në negociatat dhe përfundimin e çfarëdo marrëveshje për amendamentimin e traktatit.¹³ Secili shtet që ka të drejtë të jetë pjesë e traktatit, ka të drejtë të bëhet palë e traktatit të amendamentuar.¹⁴ Duhet thënë, sidoqoftë, se marrëveshja e amendamentuar nuk e detyron shtetin që tashmë është palë e traktit, por nuk bëhet palë e traktatit të amendamentuar.¹⁵

e. Rezervat

Një rezervë është e përkufizuar, sipas nenit 2(1)(d) të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, si një deklaratë e njëanshme e bërë nga një shtet kur nënshkruan, ratifikon, pranon, miraton, ose aderon në një traktat, me qëllim përjashtimi ose modifikimi të efektit ligjor të

¹⁰ *Id.* neni 19, para. 1.

¹¹ *Id.*

¹² *Id.* para. 2.

¹³ Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, *supra* note 2, neni 40 (2).

¹⁴ *Id.* neni 40(3).

¹⁵ *Id.* neni 40(4).

dispozitive të caktuara të traktatit në aplikimin e tyre në atë shtet.¹⁶ Sipas nenit 19 të Konventës, një shtet, kur nënshkruan, ratifikon, pranon, miraton apo aderon në një traktat, mund të formulojë një rezervë për aq sa: (a) rezerva nuk ndalohet nga traktati; (b) traktati parasheh se mund të bëhen vetëm rezerva të specifikuar, që nuk përfshijnë rezervën në fjalë; ose (c) në rastet që nuk bien brenda nën-paragrafeve (a) dhe (b), rezerva është e mospërputhshme me objektin dhe qëllimin e traktatit.¹⁷ Një rezervë, e autorizuar në mënyrë shprehimore nga traktati, nuk kërkon pranimin e mëpastajmë nga shtetet e tjera kontraktuese, përveç nëse traktati e kërkon këtë.¹⁸

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në mendimin e saj këshillëdhënës në rastin e *Rezervave ndaj Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit*, ka përshtatur standardin e “objektit dhe qëllimit”, si standard për përcaktimin e vlefshmërisë së rezervave ndaj traktateve që nuk përmbajnë dispozita lidhur me rezervat.¹⁹ Sipas mendimit të Gjykatës, secili shtet palë përcakton nëse një rezervë nga një shtet tjetër palë është në pajtim me objektin dhe qëllimin e traktatit.²⁰ Ky standard është kodifikuar në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, si dhe është përshtatur prej shumë marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, siç është për shembull Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, e cila parasheh se, “një rezervë e mospërputhshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente nuk do të lejohet.”²¹ Disa marrëveshje të tjera për të drejtat e njeriut përmbajnë dispozita të posaçme për përcaktimin e vlefshmërisë së një rezerve. Për shembull, neni 20(2) i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor parasheh refuzimin e një rezerve nëse dy të tretat e shteteve palë e kundërshtojnë atë rezervë.²²

f. Deklaratat dhe kuptimet

Kur nënshkruan ose aderon në një marrëveshje ndërkombëtare, një shtet mund të bëjë një deklaratë të njëanshme që nuk ka kuptimin e rezervës. Sido që të quhet, nëse qëllimi është të përjashtojë, kufizojë ose modifikojë detyrimet ligjore të shtetit, është në fakt rezervë. Ka raste, sidoqoftë, kur një deklaratë ka domethënie e një “kuptimi,” një interpretimi të marrëveshjes në një aspekt apo kuptim të veçantë. Një deklaratë e këtillë nuk është rezervë në rast se reflekton pikëpamjen e pranuar të marrëveshjes.

g. Shfuqizimi i traktateve

Shfuqizimi i traktateve bëhet me marrëveshje shprehimore të palëve, ose ka raste kur disa traktate janë lidhur për një periudhë të caktuar kohore. Një traktat, sidoqoftë, pushon së pasuri efekt, edhe për qëllime të ndryshme nga ato kur palët merren vesh ashtu—për shembull, pas

¹⁶ *Id.* neni 2(1)(d).

¹⁷ *Id.* neni 19.

¹⁸ *Id.* neni 20 (1).

¹⁹ *Reservations to the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide*, 1951 I.C.J. 15.

²⁰ *Id.*

²¹ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, neni 28(2).

²² *Shih* Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

shkeljes materiale (serioze) së traktatit, pamundësisë së përmbushjes së detyrimeve, ose ndryshimit fundamental apo rrënjësor të rrethanave.

Duhet të vërehet, megjithatë, se traktate të caktuara shumëpalëshe, veçanërisht për të drejtat e njeriut, mund të mos shfuqizohen nga palët, edhe në rast të mungesës së një ndalese të këtillë shprehimore të vetë traktatit. Për shembull, duke reaguar ndaj qëllimeve të Koresë së Veriut për të shfuqizuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, pas kritikave për praktikën e të drejtave të njeriut në këtë vend, Komiteti për të Drejtat e Njeriut—trupi monitorues i këtij pakti—ka ardhur në përfundimin se Pakti nuk lejon shfuqizim ose tërheqje—qoftë edhe në mungesë të një dispozite për shfuqizim—pasi Pakti ka kodifikuar të drejta universale të njeriut që u takojnë individëve, dhe jo shteteve palë.²³

h. Interpretimi i traktateve

Marrë parasysh natyrën e vetë gjuhës, por edhe faktorë të tjerë të lidhur me hartimin e tekstit ligjor, interpretimi ligjor është i rëndësishëm për shkak të efekteve që prodhon. Përëgjatë viteve të aplikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe problemeve të lidhur me to, janë ngritur qasje të ndryshme që përpiqen të ofrojnë zgjidhje të duhura për çështjen e interpretimit. Kështu, këto qasje kryesore ndaj interpretimit të traktateve janë shfaqur në proces: (i) qasja e kuptimit të zakonshëm tekstual (*the ordinary meaning textual approach*); (ii) qasja e kuptimit të zakonshëm kontekstual (*the ordinary meaning contextual approach*); (iii) qasja teleologjike ose e qëllimit përfundimtar; dhe (iv) qasja e orientuar nga politikat ose qasja konfigurore. Theksi i dy të parave vendoset te qëllimi i interpretimit të traktatit si diçka që duhet të vë në jetë qëllimin origjinal të palëve, derisa dy qasjet e tjera (*iii* dhe *iv*), ndonëse nuk e hedhin poshtë rëndësinë e qëllimit të palëve, u japin peshë edhe aspekteve të tjera.

(i) Qasja e kuptimit të zakonshëm tekstual

Kjo qasje, e përkrahur e pakta në të kaluarën nga Instituti i të Drejtës Ndërkombëtare (*Institut de Droit International*) kufizohet në interpretimin brenda tekstit të traktatit. Përqendrimi i kësaj qasjeje është në analizën e fjalëve të përmbajtura në një traktat sipas “kuptimit të tyre të dukshëm dhe të natyrshëm.” Siç është thënë nga një anëtar i mëhershëm i këtij Instituti dhe ish këshilltar kryesor ligjor në Zyrën e Jashtme Britanike, Sir Eric Beckett, “[d]etyra e një tribunali është ajo e interpretimit të një dokumenti të shkruar, një statuti, testamenti, kontrate të shkruar, apo traktati, dhe ai duhet të veprojë mbi supozimin se e gjen qëllimin të shprehur në fjalët e dokumentit të cilin duhet ta interpretojë.”²⁴

(ii) Qasja e kuptimit të zakonshëm kontekstual

²³ *Shih* Human Rights Committee, General Comment No. 26, U.N. Doc. CCPR/C/21/Rev.1/Add.9 (1997).

²⁴ *Comments on the Report of M.H. Lauterpacht (of the Second Commission of the Institute of International Law) on the Interpretation of Treaties*, 43-I ANN. INST. D. INT'L 437-38 (1950).

Qasja e kuptimit të zakonshëm kontekstual është më liberale dhe më e gjerë sesa ajo e kuptimit të zakonshëm tekstual. Kjo më së miri shprehet në nenet 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Kështu, sipas nenit 31 të kësaj Konvente:

1. Një traktat do të interpretohet në mirëbesim në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u jepet termave të traktatit në kontekstin e tyre në dritën e objektit dhe qëllimit të tij.

2. Konteksti për qëllimin e interpretimit të një traktati do të përmbajë, përveç tekstit, duke përfshirë hyrjen e tij dhe anekset:

(a) çdo marrëveshje që ka të bëjë me traktatin i cili është bërë ndërmjet të gjitha palëve në lidhje me përfundimin e një traktatit;

(b) çdo instrumenti i cili është bërë nga një ose më shumë palë në lidhje me përfundimin e traktatit dhe i pranuar nga palët e tjera si një instrument që ka të bëjë me traktatin.

3. Do të merren parasysh, bashkë me kontekstin:

(a) çdo marrëveshje e mëvonshme ndërmjet palëve përsa i përket interpretimit të traktatit ose zbatimit të dispozitave të tij;

(b) çdo praktikë e mëvonshme në zbatimin e traktatit, i cili vendos marrëveshjen e palëve në lidhje me interpretimin e tij;

(c) çdo rregull përkatës i të drejtës ndërkombëtare i zbatueshëm në marrëdhëniet ndërmjet palëve.

4. Një termi do t'i jepet një kuptim i posaçëm në qoftë se është vendosur se palët kishin pasur këtë qëllim.

Neni 32 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve përcakton mjetet plotësuese të interpretimit. Përmbajtja e kësaj dispozite është për sa vijon:

Mund të kërkohet ndihma e mjeteve plotësuese të interpretimit, duke përfshirë punën përgatitore të traktatit dhe rrethanat e përfundimit të tij, me qëllimin për të konfirmuar kuptimin që rezulton nga zbatimi i nenit 31, ose për të përcaktuar kuptimin kur interpretimi sipas nenit 31:

(a) e le kuptimin të paqartë ose të pakuptueshëm; ose

(b) çon në një rezultat i cili është në mënyrë të qartë absurd ose i paarsyeshëm.

Pra, si mjet ndihmës përcaktohet edhe “puna përgatitore” që ka çuar në nënshkrimin e traktatit, ndryshe e njohur si *travaux préparatoires* (diçka që në kontekstin e brendshëm juridik njihet si “historia legjislative”) dhe “rrethanat e përfundimit” (ose të lidhjes) të traktatit. Sipas komentarit të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare bërë nenit 31, përmbajtja e kësaj dispozite është në pajtim me praktikën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.²⁵

(iii) Qasja teleologjike ose e qëllimit përfundimtar

²⁵ *Shih* International Law Commission, Report on the Law of Treaties, UN GAOR 19th Sess., Supp. No. 9, at 27, UN Doc. No. A/5809 (1964), *rishtypur në* 61 A.J.I.L. 253 (1967).

Kjo qasje, ndonëse nuk mohon elementët e theksuar të dy qasjeve paraprahe, i jep rëndësi të veçantë qëllimeve themelore ose të fundme të një traktati, veçanërisht kur fjala është për traktatet konstitutive.²⁶

Në jurisprudencën e saj, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka pranuar rëndësinë e aplikimit të qëllimeve të traktatit kur gjuha e traktatit nuk është definitive ose kur ajo është e paqartë. Gjykata është mbështetur, për shembull, në qëllimet e traktatit kur është përfshirë në interpretimin dhe aplikimin e Kartës së Kombeve të Bashkuara, në mënyrë të veçantë në rastin e *Dëmshpërblimit*²⁷ [apo *Reparacionit*] (ku ka ardhur në përfundimin se Kombet e Bashkuara kanë personalitet ligjor ndërkombëtar, duke u mbështetur në qëllimet e përcaktuara në Kartë) dhe në rastin e *Shpenzimeve të Caktuara*²⁸ (kur roli i Asamblesë së Përgjithshme për organizimin e forcave paqeruajtëse është mbështetur në qëllimet e Kartës). Gjykatësi Jessup, në mendimin e tij mospajtuës në *rastin e Afrikës Jugperëndimore*, ka nënvizuar rëndësinë e qasjes teleologjike në interpretimin e një traktati siç është Karta e Kombeve të Bashkuara.²⁹

(iv) *Qasja e orientuar nga politikat ose qasja konfigurative*

E dallueshme nga të gjitha qasjet e mësipërme është qasja konfigurative ose e orientuar nga politikat (*policy-oriented approach*), e përkrahur nga Myres S. McDougal, Harold D. Lasswell dhe James C. Miller.³⁰

Duke ndërtuar mbi bazën e tri qasjeve të tjera, dhe në raste të caktuara edhe duke u shmangur prej tyre, përmbajtja e kësaj qasjeje është se (i) janë qëllimet e palëve—“pritjet e tyre të vërteta,” që nuk janë patjetër qëllimet e tyre origjinale—të cilat, bashkë me politikat thelbësore komunitare, duhet të karakterizojnë ndërmarrjen interpretative; dhe (ii) çdo gjë tjetër që hedh dritë në këto pritje (përfshirë, sigurisht, tekstin e traktatit), duhet të përfshihen në hetimet e interpretuesit.

Si rezultat, autorët e kësaj qasjeje inkurajojnë hetimin e të gjithë faktorëve relevantë të “para-rezultatit” (negociatat), “rezultatit” (tekstin e traktatit), dhe “pas-rezultatit” (sjelljen e mëpastajme) si indikatorë të qëllimit dhe preferencës. Duke propozuar një seri parimesh të përmbajtjes dhe procedurës për qëllime lehtësimi të trajtimit sa më të plotë të mundshëm të të gjitha dëshmimeve relevante për qëllimin e palës dhe preferencën komunitare, autorët e kësaj qasjeje refuzojnë të pranojnë ndonjë hierarki të paracaktuar të kërkimit faktik, pasi “rëndësia e një faktori të veçantë mundet në kontekste të ndryshme të ndryshojë shumë në varësi të faktorëve të tjerë.”³¹

²⁶ Për më shumë, shih DAVID H. OTT, *PUBLIC INTERNATIONAL LAW IN THE MODERN WORLD* 195-96 (1987).

²⁷ *Reparation for Injuries Suffered in the Service of the United Nations* (Advisory Opinion), 1949 ICJ 174.

²⁸ *Certain Expenses of the United Nations* (Article 17, paragraph 2, of the Charter) (Advisory Opinion), 1962 ICJ 151.

²⁹ Shih *South West Africa* (Ethiopia v. South Africa) (*Liberia v. South Africa*) (Second Phase), 1966 ICJ 6.

³⁰ SHIH MYRES S. MCDUGAL, HAROLD D. LASSWELL & JAMES C. MILLER, *THE INTERPRETATION OF AGREEMENTS AND WORLD PUBLIC ORDER* (1967).

³¹ *Id.* fq. 116. Për një diskutim më të fundit rreth interpretimit të trakteteve, përfshirë interpretimin e traktateve në më shumë se një gjuhë, shih ANTHONY AUST, *MODERN TREATY LAW AND PRACTICE* (2000).